



Prishtinë, 24.06.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1539_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2293_03_22** i dt.22.03.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **21.04.2022**;

në seancën e mbajtur më datë **24.06.2022** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin F.GJ nga komuna e Besianës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRrE/DMK_V_2293_03_22, i datës 22.03.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 22.03.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2293_03_22 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit dhe e ka obliguar KESCO-n që të anuloi Faturat nr. 11200DPR-90057168 datë 19.11.2020, nr.12200DPR-90057168 datë 21.12.2020 dhe nr. 01210DPR-90057168 datë 22.01.2021 dhe se për këto periudha te faturojë me shpenzimet e regjistruara në njehsorin nr. 56680653 për periudha të njëjta(11/2021, 12/2021 dhe 01/2022).

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Departamenti në shërbime për konsumatorë në KESCO konstaton se faturimi në periudhën 11/2020 deri 01/2021 është i saktë dhe është bërë sipas gjendjes së regjistruar në njehsor.
- ZRrE/DMK vendimin e saj e arsyeton në shpenzim mesatar për periudhën e njejtë Nëntor, Dhjetor dhe Janar të viteve paraprake dhe vijuese duke theksuar mospërputhje të shpenzimeve mesatare.
- KESCO ka lexuar leximet AMR për njehsorin 55276089 dhe bazuar në rrjedhën e tyre nuk ka dyshime që mund të ketë ndikuar në saktësi të matjes.
- Duke pasur parasysh shpenzimin në periudha tjera shihet se konsumatori ka pasur shpenzime më të larta edhe në periudhë tjetër, si p.sh periudha 06/2020 me shpenzim prej 901 kËh.
- Periudha Nëntor, Dhjetor dhe Janar njihet si periudhë e sezonës dimërore dhe është e njohur që në këtë periudhë zakonisht rritet edhe shpenzimi, mund të konstatohet që krahasimi në



periudha paraprake apo vijuese nuk mund të jetë gjithmonë i saktë pasi konsumatori mund të ketë shfrytëzuar energjinë elektrike për ngrohje dhe shpenzimi i tij mund të jetë më i lartë në këtë rast.

- Duke marrë parasysh që shpenzimi ka nodhur gjatë sezonës dimërore dhe faktin që nuk është bërë shqyrtimi i saktësisë së matjes së njehsorit, atëherë konstatimi se konsumatori nuk e ka shpenzuar energjinë elektrike të faturuar nuk mund të jetë i saktë dhe real.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2293_03_22 i datës 22.03.2022 për konsumatorin F.GJ.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pretendimit se faturimi për periudhat në fjalë është i saktë, Bordi thekson se pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si: Ankesës së konsumatorit në KESCO e datës 04.03.2021; Procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.0023142 datë 31.10.2020; Procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.009550 i datës 08.03.2021; Përgjijen e KESCO-s të datës 06.04.2021; Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRRE-së të datës 04.06.2021; Rrjedhën e energjisë elektrike; Listat e leximit; Vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2293_03_22 i datës 22.03.2022 dhe Kundërshtimin e KESCO-s të datës 21.04.2022, erdhi në përfundim se faturimi i kWh për periudhat 11/12/2020 dhe 01/2021 nuk mund të paraqet shpenzim real të konsumatorit.

Bordi, në shqyrtim e sipër të rastit, gjeti se fillimisht, me datë 31.10.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 64680574 me gjendje TL=004917 kWh dhe TU=000087 kWh dhe kanë vendosur për matje njehsorin e ri elektrik nr. 55276089 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se behët ndërrimi i njehsorit të vjetër i cili dërgohet në qendrën e kalibrimit dhe vendoset PLC. Departamenti i faturimit në KEDS me datë 19.11.2020 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën Nëntor 2020 me **2,366 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **224.39€**, me datë 21.12.2020 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën Dhjetor 2020 me **5,182 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **495.74€** si dhe me datë 22.01.2021 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën Janar 2021 me **1,295 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **116.38€**. I pakënaqur me obligimin e ngarkuar, me datë 04.03.2021 konsumatori parashtron ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturat e muajit Nëntor, Dhjetor 2020 dhe Janar 2021 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 55276089. Më tutje me datë 08.03.2021 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 55276089 me gjendje TL=003208 kWh dhe TU=005634 kWh dhe kanë vendosur për matje njehsorin e ri elektrik nr. 56680653 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se me urdhëresë behët ndërrimi i njehsorit. Ndërsa, me datë 06.04.2017 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit me një njoftim bazuar në procesverbalin nr. 0009550 datë 08.03.2021, si dhe kanë informuar se pas shqyrtimit të njehsorit KEDS do të dal me një raport për shqyrtim-verifikim të njehsorit. Konsumatori, pas pranimit të përgjigjes



nga KESCO, me datë 04.06.2021 parashtron ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO si dhe ka kundërshtuar faturat e muajit Nëntor, Dhjetor 2020 si dhe Janar 2021 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 55276089. Me datë 22.03.2022 DMK pranë ZRRE-së e aprovon ankesën e palës dhe kërkon anulimin e faturave nga KESCO për periudhat e caktuara në këtë rast dhe rifaturimin e tyre duke u bazuar në shpenzimet e regjistruara në njehsorin nr.56680653. Bordi pasi ka shqyrtuar të gjithë rrjedhën e rastit dhe provat e nevojshme, konstaton se vendimi i marrë nga DMK, është vendim i bazuar në ligj dhe si i tillë e arsyeton faktin se konsumatori për periudhat e caktuara Nëntor, Dhjetor 2020 dhe Janar 2021 është faturuar më kosto të lartë andaj është e nevojshme që të bëhet rifaturimi i tyre me njehsorin e ri të vendosur.

Më tutje, gjatë analizimit të faturimit të periudhave të lartëcekura, ZRRE ka gjetur se KESCO nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *1. "Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit. 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese".*

Pas analizimit të rrjedhës së energjisë elektrike, Bordi ka gjetur se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore dhe se vetëm në disa periudha ka evidentuar që nuk ka qasje në leximin e njehsorit elektrik, e që kjo periudhë nuk ka të bëjë me njehsorin kontestues, dhe se në asnjë rast nuk ka evidentuar që dyshon se njehsori nuk bën matje të saktë. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhën kontestuese si dhe më të hershme dhe më të vonshme me tre njehsorë elektrik, njehsorin nr. 64680574, nr. 55276089 dhe nr. 56680653 konstatohet se faturimi i shpenzimeve për periudhat 11/12/2020 dhe 01/2021 nuk përputhët me shpenzimet e konsumatorit në periudha të njëjta. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike shpenzimet e regjistruara me njehsorin elektrik nr. 64680574 për periudhën 11/2017 është **75 kWh**, periudha 12/2017 është **135 kWh**, periudha 01/2018 është **152 kWh**, periudhën 11/2018 është **52 kWh**, periudha 12/2018 është **121 kWh**, periudha 01/2019 është **153 kWh**, 11/2019 është **36 kWh**, periudha 12/2019 është **00 kWh**, periudha 01/2020 është **176kWh** kurse me njehsorin kontestues nr. 55276089 periudhat: 11/2020 është **2,366 kWh**, 12/2020 është **5,182 kWh** dhe periudhën **01/2021 është 1,295 kWh**, kurse me njehsorin e ri nr. 56680653 periudha 11/2021 është **5.83 kWh**, periudha 12/2021 është **52 kWh** dhe periudhën 01/2022 është **41 kWh**.

Bordi ka shqyrtuar faturat kontestuese të konsumatorit dhe duke pasur parasysh shpenzimin e përgjithshëm të energjisë elektrike të konsumatorit konstaton se faturimi i kWh për periudhat 11/12/2020 dhe 01/2021 nuk mund të paraqet shpenzim real të konsumatorit. Bazuar në këtë ZRRE konstaton se konsumatorit duhet ti anulohen faturat nr. 11200DPR-90057168 datë 19.11.2020, nr.12200DPR-90057168 datë 21.12.2020 dhe nr. 01210DPR-90057168 datë 22.01.2021 dhe të njezat periudha të faturohen në bazë të shpenzimeve të regjistruara në njehsorin e ri të vendosur.



Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në kundërshtimin e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit F.GJ dhe
- Arkivit të ZRRE-së.